



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit/ Državni Tužilac/ State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit/ Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor

A.nr. 162/2021

Datë: 27/05/2021

Prishtinë;

Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me nenin 1 paragrafi 1 dhe pika 1.1, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit nr.05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit me qëllim që të rregullojë mënyrën e dorëzimit-pranimin apo marrjes së lëndëve të prokurorëve të suspenduar-pezualluar me qëllim të zbatimit unik të praktikave në të gjitha prokurorit dhe pas ndryshimeve ligjore e nënligjore nxjerrë këtë:

UDHËZIM

Për dorëzim-pranimin e lëndëve në rast të suspendimit-pezuallimit nga detyra

1. Prokurorit të suspenduar – pezulluar me vendim të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) duhet t'i lejohet qasja në zyrë e tij me komision për t'i dorëzuar lëndët me të cilat është i ngarkuar. Me rastin e dorëzimit të lëndëve hartohet procesverbal i cili nënshkruhet nga prokurori i suspenduar – pezulluar dhe anëtarët e komisionit. Komisioni kryesohet nga Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse, një prokuror i asaj prokurorie dhe administratori. Caktimin e prokurorit në komision e cakton kryeprokurori i prokurorisë përkatëse.
2. Në rast të suspendimit – pezullimit të Kryeprokurorit të ndonjë prokurorie, zbatohet procedura e njëjtë e dorëzimit të lëndëve, me përjashtim të përbërjes së komisionit ku kryesuesi i komisionit në këtë rast është zëvendës-kryeprokurori i asaj prokurorie. Caktimin e prokurorit në komision e cakton zëvendës-kryeprokurori.
3. Në rastin kur prokurori i suspenduar është në pamundësi fizike që t'i dorëzojë lëndët, ngase ndaj të njëjtit Gjykata ka shqiptuar masën e paraburgimit, apo ndonjë masë tjetër për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale, atëherë komisioni (siç është cekur me pikën 2) brenda afatit prej pesë (5) ditësh i merr lëndët nga zyra e prokurorit të suspenduar dhe harton procesverbal ku konstaton numrin e lëndëve dhe natyrën e lëndëve sipas regjistrave (PP, PPN, PPP dhe të tjera).

Procesverbali nënshkruhet nga anëtarët e komisionit dhe zyrtari përkatës i ngarkuar me lëndët e prokurorit të suspenduar. Në rastin kur suspendohet Kryeprokurori i ndonjë prokurorie zbatohet procedura e njëjtë e dorëzimit të lëndëve me përjashtim të përbërjes së komisionit (siç është e cekur në pikën 3).

4. Njoftimi për suspendimin – pezullimin e prokurorit bëhet nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Një kopje e njoftimit për vendimin i dërgohet Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse, ndërsa në rastet e suspendimit të Kryeprokurorit të ndonjë prokurorie, njoftimi i dërgohet Kryeprokurorit të Shtetit dhe zëvendës-kryeprokurorit të asaj prokurorie.
5. Kryeprokurori apo prokurori i suspenduar – pezulluar, apo edhe komisioni në rastet kurë prokurori ose kryeprokurori janë në pamundësi fizike për dorëzimin, lëndët i dorëzon sipas procedurës së paraparë në këtë udhëzim duke specifikuar natyrën e lëndëve dhe statusin e tyre. Procesverbal i duhet në veçanti të përmbajë shënim për lëndët e natyrës urgjente si në vijim;
 - Lëndët në hetime në të cilat ndaj të pandehurit është urdhëruar paraburgimi apo ndonjë masë tjetër për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurë;
 - Lëndët në hetime të cilat prokurori i suspenduar – pezulluar mendon se janë përfunduar hetimet dhe se duhet të ushtrohet aktakuzë apo pushohet hetimi.
 - Lëndët tjera në hetime;
 - Kallëzimet penale që nuk janë vendosur brenda afatit nga neni 82 paragrafi 1 i KPPK-së ose neni 83 paragrafi 5 i KPPK-së;
 - Lëndët me aktakuza në të cilat është pranuar aktgjykimimi dhe është duke rrjedhë afati për ankesë;
 - Lëndët me aktakuza në të cilat është caktuar shqyrtimi gjyqësor apo shqyrtimi është në rrjedhë e sipër, dhe
 - Lëndët tjera nga regjistrat PPN dhe PP që i suspenduari i ka në punë.
6. Dorëzimi i lëndëve të prokurorit të suspenduar - pezulluar bëhet nga vet prokurori tek Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse nëse dhe me rastin e dorëzimit të lëndëve hartohet procesverbal dhe i njëjti nënshkruhet nga prokurori, Kryeprokurori dhe administratori i prokurorisë përkatëse. Dorëzimi i lëndëve bëhet sipas renditjes së paraparë më pikën 5 të këtij udhëzimi. E njëjta procedurë zhvillohet edhe në rastin e dorëzimit të lëndëve nga Kryeprokurori i suspenduar tek zëvendës – kryeprokurori i prokurorisë përkatëse.
7. Ndërsa, sa i përket lëndëve të prokurorëve të avancuar, të transferuar dhe prokuroreve në pushim të lehonisë ndarja e lëndëve bëhet sipas Rregullores së KPK-së, NR. 02/2019 Për Administrimin dhe Ndarjen e Lëndëve në Prokurorin e Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Kryeprokurori i Shtetit.

Ky udhëzim e shfuqizon udhëzimin e mëparshëm me A.nr. 277/2016 të datës 16 maj 2016.

Mos respektimi i këtij udhëzimi mund të konsiderohet si shkelje të Kodit të Etikës për kryeprokurorë dhe prokurorë.

Kryeprokurori i Shtetit

Aleksander Lumezi



Udhëzimi i dërgohet;

- Kryeprokurorëve të prokurorive dhe të gjithë prokurorëve të shtetit;
- Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH).

Obligohet administrata e ZKPSH-së që këtë udhëzim ta publikoj në ueb faqen e Prokurorit të Shtetit.